



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 22

Datë: 20. 07. 2023. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alban Krasniqi, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiš, Fazli Stollaj.

Burim Ahmetaj, kryeshef i SKQZ.

Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Raportet e Këshillave të KQZ-së

- **Këshilli për Operacione Zgjedhore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i projektit: Informimi i Votuesve për Caktimin dhe Ndërrimin e Qendrave të Votimit ,

Shqyrtimi dhe miratimi i Konkursit: Kompozimi i Melodisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

- **Këshilli për Çështje Ligjore**

-Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësim e anëtarëve të kuvendit komuna në Zubin Potok dhe Klinë

3. Të ndryshme

1.Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Mirë se keni ardhur në mbledhjen nr. 22 të KQZ. Agjendën e keni, a ka dikush ndonjë propozim ?

Burim Ahmetaj: Duhet të diskutojmë për ligjin mbi zgjedhjet, por duhet me qenë pikë e mbyllur.

Në ndërkohë me 10 vota për, miratohet rendi i ditës.

2. Raportet e Këshillave të KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i projektit: Informimi i Votuesve për Caktimin dhe Ndërrimin e Qendrave të Votimit:

Arianit Elshani: KOZ - i ka shqyrtuar këtë projekt, siç e kemi të paraparë edhe mbi bazën e planit të punës së këtij viti dhe reformës zgjedhore, informimi i votuesve tani do të bëhet gjatë gjithë vitit. Si projekt, ne e kemi shqyrtuar, kemi dhënë komentet, sepse kjo është një mundësi shumë e mirë për votuesit. E kemi shqyrtuar edhe buxhetin e këtij projekti...!

Është një buxhet racional, një pjesë e mjeteve do të shkoj për dërgimin e “SMS”-ve dhe një pjesë e vogël për informimin publik. Të tjerat, bëhen përmes operatorëve si RTK ku do të shfaqen animacionet...

Me 10 vota për, miratohet ky projekt.

Shqyrtimi dhe miratimi i Konkursit: Kompozimi i Melodisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:

Arianit Elshani: KOZ-i, po ashtu ka shqyrtuar edhe çështjen e konkursit publik të melodisë së KQZ-së. Është një projekt i paraparë. Duke e ditur se kemi bërë shpenzime në çdo proces zgjedhor, e ku është dashur të kontraktohet një lloj melodie, ne tani po bëjmë përpjekje ta kemi një melodi standarde e

zgjedhjeve. Komisioni vlerësues, shpresojmë do të jetë nga fakulteti i Arteve. Rishpallja e konkursit, ka ndikuar edhe në rritjen e vlerës së konkursit në pikëpamje materiale, meqë në konkursin që u mbyll, nuk kishte të interesuar...

Alban Krasniqi: Në lidhje me këtë, pra me projektin e melodisë. E kemi shpallë, por ka dështuar. E kemi analizuar më thellë, dhe nuk kishte pajtueshmëri. Nuk është bindëse ky projekt, melodia! Kemi analizuar nëse ka dikun praktika të këtilla, por del që nuk ka dhe meqë nuk ka, pse kemi ne nevojë ta kemi një “melodi”, pra një praktikë të këtillë...?

Pse të kufizohemi, sepse ndoshta në të ardhmen nuk do të jetë praktike për shkak të procesit! Dyshoj që do të ketë sukses, pra duhet ti kemi parasysh se mund të shpenzojmë mjete, por të mos kemi pajtueshmëri. Mendoj që nuk ka naj peshë, dhe ndoshta lodhemi kot. Jam i rezervuar dhe nuk do ta mbështesë...

Sami Hamiti: E kemi diskutue gjatë, mirëpo ne po harrojmë se kemi vendosur njëherë. Ne, mendoj që kemi dështuar në mjete, domethënë në shpërblim...Nuk ka pas oferta, mirëpo ne kemi vendosur njëherë, pra ta kemi një “melodi” tingullore, të përhershme që kur bie tregon imazhin, refleksionin e zgjedhjeve. Unë mendoj ndryshe, është mirë të jetë...!

Nga këndvështrimi im, është mirë të jetë...Kemi vendosur njëherë...

Me 9 vota për, dhe një kundër (Alban Krasniqi) u vendos që të rishpallet ky konkurs.

Këshilli për Çështje Ligjore

Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesave për zëvendësim e anëtarëve të kuvendit komuna në Zubin Potok dhe Klinë:

Sami Hamiti: Kemi shqyrtuar kërkesat e dy kryesuesve të kuvendeve komunale për zëvendësime: nga komuna e Klinës dhe e Zubin Potokut. Dhe në të dy rastet, plotësohen kushtet ligjore për zëvendësime. Ka elemente specifike ligjore, sepse në Klinë zëvendësohet një burrë me një grua meqë kështu pasohet sipas ligjit, kurse në Zubin Potok, kemi zëvendësimin e një asamblisti të PDK-së nga një i VV-së.

Alban Krasniqi: Po e ndaj një shqetësim ! Është një rast që nuk ka ardhur në shqyrtim, pra është vonesë dhe kjo shkakton vakum. Kjo mund të ketë pasoja në jetën politike dhe vendimmarrje të komunave prej

nga vijnë. Po tu referohemi dokumenteve, kërkesa nga Zubin Potoku ka zgjatur gati një muaj deri sa është shqyrtuar. Kërkesa ka ardhur më 27.06. 2023, dhe sot jemi në 20, 07 dhe ka zgjatur gati një muaj...

Anëtari Krasniqi, kritikoi neglizhencën, procedurat dhe punën e administratës në Sekretariat lidhur me vonesat në procedimin e kërkesave. Ai pastaj, mori shembull edhe një rast në komunën e Prishtinës. Në kontekst, ai elaboroi “shqetësimet” e tij duke kërkuar që, “problemet e këtilla” më tej mos të përsëriten, pra të mos ketë vonesa të pa arsyeshme...

Në lidhje me vërejtjet e z. Krasniqi, diskutoi dhe bëri shpjegimet në këtë aspekt, Sami Hamiti nga këshilli ligjor. Sidomos, ato që lidhen me çështjet e komunikimit, të kërkesave dhe të procedimit lidhje me zëvendësimet, në cilin do rast...

Ilir Gashi tha se, nuk kemi pasur informacion se dikush ka plotësuar kriterit të zëvendësimit, dhe çështja nuk është proceduar më tej.

Në këtë pikë, diskutoi edhe Sami Kurteshi cili tha se, nëse ngecjet, pengesat burokratike kanë ndikuar unë, jam që kjo të shihet, pra të shihet dhe të mos përsëritet ma ! Po më duket e çuditshme, mirëpo kjo po më bënë përshtypje, madje kërkoja edhe nga zyrtarja ligjore se, çka është duke ngjarë me rastin...

Arianit Elshani, po ashtu tha se, edhe unë nuk e di se çka ka ndodhur, ku ka mbete çështja, se pse është zgjatë kaq shumë... Është mirë të na tregohet, sepse nuk po dëshiroj të paragjykoj... Mirë është që edhe çështja e Prishtinës, të na shpjegohet...

Emira Alushi, nga Zyra Ligjore, shpjegoi në pika të gjera rrjedhën e çështjes, fillimisht të Zubin Potokut. Është e vërtetë që shkresa mban datën “27.06. 2023”, mirëpo unë miellin si kërkesë e kam pranuar më datën 3 korrik, mirëpo kërkesës i ka munguar “kërkesa e kryesuesit” në lëndën që ka ardhur...

Zyrtari ynë e ka përcjellë kërkesën tonë, dhe në ndërkohë, është sjellë kërkesa. Pas shqyrtimit, konstatimi ynë në bazë të listës është se “një kandidatë” është me numër më të madh të votave. Dhe, bëhet fjalë për dikën tjetër. Zyrtari ynë e ka kthyer shkresën, dhe ia ka bashkangjitur edhe “deklaratën”. Pastaj, kam proceduar më tutje, gjithnjë sipas procedurave ligjore. Tani, lënda – kërkesa është e kompletuar...

Gjithashtu, znj. Alushi, shpjegoi edhe “rastin e Prishtinës” të cilin, e potencoi z. Alban Krasniqi.

Në këtë pikë, diskutuan më tej: Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ariaint Elshani, Čemailj Kurtiš, Sami Kurteshi, Kreshnik Radoniqi dhe Burim Ahmetaj.

Pas përfundimit të të gjitha diskutimeve, kryetari Kreshnik Radoniqi, paraqiti zëvendësimet:

1. Në komunën e Klinës, i dorëhequri Shemsedin Berisha, zëvendësohet nga Leonora Jahaj – Daka nga subjekti politik AAK.

Me 10 vota për, dhe një abstenim (Gordana Llaban) miratohet ky zëvendësim.

2. Në komunën e Zubin Potokut, i dorëhequri Sefer Veseli nga subjekti politik PDK zëvendësohet nga Shaban Deliu nga subjekti politik Lëvizja “Vetëvendosje!”

Me 10 vota për, dhe një abstenim (Gordana Llaban) miratohet ky zëvendësim.

3. Të ndryshme !